



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.951/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Nazife Kokollari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.951/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Nazife Kokollari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2004A/04R, 2042A/13R, 2003A/03R, 2007A/05R, 2013A/01R, 2029A/02D, 2029A/01R, 2008A/05R dhe 2004A/05R.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga e kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Nazife Kokollari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren në të cilën pretendon se në vendvotimet 2004A/04R, 2042A/13R, 2003A/03R, 2007A/05R, 2013A/01R, 2029A/02D, 2029A/01R, 2008A/05R dhe 2004A/05R i mungojnë votat e konfirmuara nga familjarët dhe ka dyshime se të njëjtat vota i janë bartur kundër kandidateve të saj nga subjekti i njëjtë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Nazife Kokollari nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren është paraqitur apeli me të cilën ka kërkuar rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet 2004A/04R, 2042A/13R, 2003A/03R, 2007A/05R, 2013A/01R, 2029A/02D, 2029A/01R, 2008A/05R dhe 2004A/05R.

Paneli, vlerëson se parashtruesja e apelit në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesen, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesja, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankueses për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankueses nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.951/2021 më datën 06.11.2021

Kryesuesi i Panelit

Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranim të këtij vendimi.